

URDHËR
Nr. 275, datë 19.5.2022

PËR PEZULLIMIN E VEPRIMTARISË SË KOLEGJIT UNIVERSITAR
“PAVARËSIA”, VLORË

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të shkronjës “k”, të pikës 2, të nenit 7, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”,

URDHËROJ:

1. Pezullimin e veprimtarisë së Kolegjit Universitar “Pavarësia”, Vlorë, për një afat maksimal dyvjeçar, duke filluar nga viti akademik 2022–2023 e në vijim, deri në plotësimin e kushteve, sipas shtojcës nr. 1, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.

2. Pezullimi i veprimtarisë së Kolegjit Universitar “Pavarësia”, Vlorë, konsiston në detyrimin që të mos regjistrojë studentë të rinj në asnjë nga programet e studimit që ofron, përfshirë studentë në vitin e parë, në vite të ndërmjetme apo dhe transferime, për të gjithë periudhën e kohëzgjatjes së pezullimit të veprimtarisë.

3. Kolegji Universitar “Pavarësia”, Vlorë, brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij urdhri, duhet të dorëzojë në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, planin e masave për zbatimin e këtij urdhri.

4. Ministria e Arsimit dhe Sportit, në rast të mospërmbushjes të kushteve të vendosura në shtojcën nr. 1 të këtij urdhri, i propozon Këshillit të Ministrave mbylljen e veprimtarisë së institucionit të arsimit të lartë.

5. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit dhe Kolegji Universitar “Pavarësia”, Vlorë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT DHE SPORTIT
Evis Kushi

SHTOJCA 1

1. Kolegji Universitar “Pavarësia”, Vlorë, të ndjekë procedurat ligjore pranë Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL) për akreditimin e institucionit.

2. Kolegji Universitar “Pavarësia”, Vlorë, të ndjekë procedurat ligjore pranë Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL) për akreditimin e programeve të studimit.

3. Kolegji Universitar “Pavarësia”, Vlorë, të marrë masa për plotësimin e kapaciteteve akademike, në përputhje me legjislacionin në fuqi, si dhe të përmbushë detyrimet ligjore mbi deklarimin e personelit akademik, pranë institucioneve përgjegjëse për tatimet dhe sigurimet shoqërore.

4. Kolegji Universitar “Pavarësia”, Vlorë, të marrë masa për pajisjen me regjistrat themeltarë të studentëve, të arritjeve akademike dhe të lëshimit të diplomave, sipas legjislacionit në fuqi.

5. Kolegji Universitar “Pavarësia”, Vlorë, të ndjekë procedurat për pajisjen e studentëve me numra matrikullimi, sipas kuadrit ligjor në fuqi.